



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	01-02	2021	1	viti god year
Organ /Mjesta Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKR/1100	408/2021		119	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.429/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional-procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokollit 3241/2020 të datës 21.12.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rr” Ali Pashë Tepelena”Nr.53 Gjilan , kundër organit të punësimit- Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.02.2021, mori këtë .

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër protokollit 3241/2020 e datës 21.12.2020, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi** vendimi i datës 09.12.2020 me nr.02-016-112440/2 i Komisionit të Pranimit.
- III. Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi ka aplikuar në pozitën: “Zyrtarat për Buxhet dhe Financa 1”, të shpallur me datë 30.06.2020 nga Komuna e Gjilanit me nr. Ref.RN00006013, në bazë të autorizimit të datës 26.06.2020 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, për shpalljen e konkursit të jashtëm, nga data 30.06.2020 deri me 14.07.2020.

Komuna e Gjilanit me datë 28.09.2020, ka njoftuar të gjithë kandidatët se së shpejti do të fillojë procedura e rekrutimit për kandidatet që do të përfshihen në listën e shkurtër, për pozitat që kanë aplikuar. Me datë 27.10.2020 janë njoftuar kandidatet për listën e ngushtë për t’ju nënshtruar testimit me shkrim dhe me gojë, ku ankuesi me datë 29.10.2020 ka marrë pjesë në testim me shkrim dhe intervista me gojë e mbajtur me datën 17.11.2020 dhe ka arritur gjithsejtë 64.9 pikë edhe atë sipas hapave: në testin me shkrim 55, në vlerësim të CV 8 pikë dhe testimi me gojë 1.9 pikë.

Ankuesi i pa kënaqur me njoftimin e datës 02.12.2020, të vlerësimit përfundimtar në afat ligjor i është drejtuar Komisionit të pranimit me ankesë të brendshme 03 nr.200-112440 të datës 04.12.2020 me pretendimet ankimore që edhe njëher të rishqyrtohet lista përfundimtare.

Komisioni i Pranimit pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit me datën 09.12.2020 ka nxjerrë vendimin me



nr.02-016-112440/2 me të cilin vendim ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi listen e vlerësimeve përfundimtare me rezultatet e shpallura me datë 02.12.2020.

Ankuesi i paknaqur me vendimin e datës 09.12.2020 me nr.02-016-112440/2 të Komisionit të Pranimit, me datë 21.12.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 3241/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.12.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit. Këshilli me datë 11.01.2020 ka pranuar dokumentacionin e bashkangjitur nga Komuna e Gjilanit, lidhur me ankesën e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3241/2020 të datës 21.12.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë e parashtruar me datën 04.12.2020 në Komisionin Përzgjedhës; Njoftim i datës 16.12.2020; ID identifikuese për [] , Diploma e datës 26.01.2018 me nr.139 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan; Çertifikatë e datës 02.08.2015; Vendim i datës 09.12.2020 me nr. 200-112440 i Komisionit të pranimit të nëpunësve civil; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 04.12.2020; Kërkesa për punësim e datës 08.07.2020 për []

Çertifikatë e datës 06.07.2020 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilanë; Diploma e datës 26.01.2018 me nr.139 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilanë; Konfirmim për qëndrueshmërin buxhetore e datës 26.06.2020; Autorizimi i MAP-it i datës 26.06.2020; Shpallja e konkursit e datës 30.06.2020 me nr.02-016-51400; Vendimi i datës 10.07.2020 me numër protokoll 576 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës për Shërbimin Civil; Regjistri i aplikacioneve të pranuar për pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa I; Raport i listës së shkurtë i datës 16.07.2020; Njoftim i datës 28.09.2020 me nr.02-016-87609; Njoftim i datës 27.10.2020 me nr.02-016-99233 për mbajtjen e testit me shkrim; Raporti i vlerësimit nga testi i mbajtur me shkrim; SIMBNJ-testimi elektronik –testi i aplikantit me kodin CN1178, pikët totale 55; Njoftim i datës 02.11.2020 me nr.02-016-102073 për kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim; Raporti për shpalljen e rezultateve përfundimtare i datës 01.12.2020; Listë përfundimtare me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve; i datës 02.12.2020 me nr.02-016/111552; E-mail zyrtar i datës 02.12.2020; CV-për []

Formularët për intervist me gojë; Njoftim i datës 15.11.2020 me nr.02-016/106614; Njoftim i datës 02/12/2020 me nr.02-016-111552; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 07.07.2020; Kërkesa për punësim për [] Pasqyra e trustit prej vitit 2002 deri 2020; Vërtetimi i kopjes nga origjinali LRP.Nr.1655/2020; Diplomë e datës 31.02.2010 me nr.2600 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës; ID-identifikuese; Vërtetim i datës 08.10.2018 i lëshuar nga SH.P.K."DIAMOND"; Çertifikatë e datës 01.07.2020 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan; CV për [] Formularët për intervist me gojë; Pëlqim i datës 07.12.2020; Raport mbi vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve i datës 14.12.2020; Akt emërimi i datës 30.12.2020 me nr.AE.Nr.02-016/01-0120352/20; Akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Kopja e testit me shkrim për [] dhe Përgjigje në ankesë e datës 11.01.2021 me numër protokoll 78/2021 nga organi i punësimit, bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit [] është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Komuna e Gjilanit gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa I" të anulohet vendimi i Komisionit të Pranimit pasi që është nxjerrë në kundërshtim me nenin 21, 22 dhe nenin 23 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se kriteret themelore të konkursit për këtë pozitë kanë qenë:

- *Diplome Universitare-Fakulteti Ekonomik, drejtimi banka, financa, kontabilitet pa përvojë pune;*
- *Ose shkollë e lartë me 2 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit;*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1” është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 21.22 dhe 23 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është i paqëndrueshëm sepse e gjithë procedura e rekrutimit për këtë pozitë është zhvilluar në pajtim me dispozitat e neni 21.22 dhe 23 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesi z. _____ i cili ka aplikuar në pozitën “Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1” i ka plotësuar kriteret e konkursit me datën 27.10.2020 përmes njoftimit me nr.02-016-99233 është njoftuar se testi me shkrim do të mbahet me datën 29.10.2020. Ankuesi ka marrë pjesë në testin me shkrim dhe është vlerësuar me 55 pikë dhe me datën 17.11.2020 ka marrë pjesë në intervistën me gojë ku është vlerësuar me 1.9 pikë, me 8 pikë për vlerësim të CV ku gjithsejtë ka marrë 64.9 pikë. Pretendim tjetër ankimor i ankuesit është se kandidati i përzgjedhur nuk ka marrë pjesë në testin me gojë dhe Komisioni i Pranimin e ka kundërshtuar këtë pretendim sepse ankuesi nuk ka pasur asnjë dëshmi për të vërtetuar këtë pretendim.

Komuna e Gjilanit, me datën 02.12.2020 ka nxjerrë njoftimin për kandidatin e suksesshëm , kandidati me më shumë pikë gjatë testit me shkrim dhe me gojë për pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1 është me 89.5 pikë

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni i pranimit me rastin e përzgjedhjes së kandidatit për pozitën “Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1” në Komunën e Gjilanit, _____ si kandidat i cila ka grumbulluar me se shumti pikë, ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se : “Shuma e pikëve të përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit”. Kandidati i përzgjedhur z _____ posedon Diplomën e datës 31.08.2010 me Nr.2600 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik –Universiteti i Prishtinës dhe mori titullin Ekonomist i diplomuar; vërtetimin e datës 08.10.2018 me të cilin vërtetohet se z. _____ ka punuar në SH.P.K.”DIAMOND”në Gjilan që nga data 01.05.2010 në pozitën Administrator-Financa dhe Arkatar me të cilën e vërteton edhe nga pasqyra e trustit pensional prej vitit 2002 deri në vitin 2020.

Komuna e Gjilanit procedurën e rekrutimit e ka filluar me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa nga njoftimi për testin me shkrim e tutje janë vazhduar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë bazuar në nenin 83 paragrafi 9.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të të gjitha provave të lëndës ka konstatuar që Komisioni i Pranimin, procedurën e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1” në Komunën e Gjilanit e ka zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë bazuar në nenin 83 paragrafi 9 dhe nenin 17, 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni i Pranimin ka vepruar në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.



Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë—Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.429/2020, datë 01.02.2021

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- *Ankuesit*
- *Kryetarit të Komunës së Gjilanit;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*